



Dalës-Izlozja

Nr. 7/109
Br.

Data 22.08.2022
Datum



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq-Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

EKSTRAKTI PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.26.07.2022, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Labinot Mirena, Ajshe Haliti Pllana, Sami Ahmeti, Nazlije Shala dhe Bajram Hashani

Të pranishmit tjerë: drejtorët komunal, Festina Preniqi, zyrtare për marrëdhënie me publikun dhe përf.e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Draft Rregullore për menaxhimin e mbeturinane në Komunën e Obiliqit
4. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve për periudhën Janar – Qershor 2022
5. Raporti i Auditimit nga ZKA për vitin 2021
6. Plani i Veprimit për zbatimin e Rekomandimeve nga ZKA
7. Shqyrtimi i kërkesave
8. Të ndryshme

Kryesuesja – Të nderuar anëtarë të KPF-së, para se të iu njoftoj me rendin e ditës, propozoj të ndryshohet rendi i ditës, ashtu që në pikën e 7, të futet raporti mbi pronat komunale sipas kërkesës së Kryetarit. Kryesuesja, i njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 7 vota për me ndryshimin e cekur më lartë.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 5 vota për dhe 2 vota kundër.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Ju materialin e keni marrë dhe hap debatin për Draft Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit.

Enver Gashi – Ne jemi për këtë Draft Rregullore dhe diskutimet mbeten për Kuvend.

Sami Ahmeti – Edhe ne jemi dakord që kjo Draft Rregullore të shkoj në seancë dhe atje, do të japim kontributin tonë për pika të veçanta.

Labinot Mirena – Pasi vijë nga një kompani e menaxhimit të mbeturinave, unë i kam disa vërejtje në çmimore, që besoj se janë çmimoret më të ulëta sepse nuk janë ndryshue që 20 vite. Ne e dijmë çështjen e ngritjes së çmimeve dhe karburantet që është ngritë jashtë mase dhe është një tarifë për konsumatorët shtëpiakë 4 e 65, që për mendimin tim është e papranueshme. Mirëpo, besoj se në Kuvend i kemi vërejtjet tona dhe besoj se do ta zgjidhim.

Kryesuesja – Po, gjithsesi, aty do të jetë Komisioni dhe Drejtoria dhe ju mund ti paraqitni vërejtjet e juaja. Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin dhe aprovimin e Draft Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Për një sqarim detal rreth raportit të shpenzimeve, për periudhën janar-qershor 2022, fjalën ia dha drejtoreshës së DEFZH-së.

Zarife Behluli – Ne ju kemi dërguar raportin e shpenzimeve janar-qershor 2022, për të gjitha kategoritë ekonomike si në vijim: Paga dhe Mëditje 2,195,248.24 €, shpenzimi është 2,089,732.67 €, do të thotë në periudhën 6 mujore 95.94 %. Mallra dhe shërbime 1,340,591.80 €, ndërsa të shpenzuara janë 399,708.29 €, do të thotë 29.82 shpenzimi. Shpenzimet komunale janë 280,675.00 €, ndërsa shpenzimi 121,345.21 €, do të thotë 43.23 %. Subvencione dhe transfere, totali i alokimit 926,370.52 €, shpenzimi 528,030.65 €, do të thotë 57 %. Shpenzimet kapitale, të alokuara 4,948,794.85 €, të shpenzuara 300,477.43 €, do të thotë 6.07%.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që shqyrtimi i raportit të shpenzimeve të shkoj në Kuvend dhe aty nëse, ka mundësi me dhënë ndonjë vërejtje.

Sami Ahmeti – Edhe ne jemi dakord që kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në seancë, por për respektin minimal të anëtarëve të Kuvendit komunal, do të ishte mirë që kur është fjala për këto raporte që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e Kryetarit, të jetë edhe ai prezentë në seancë. Është më e vogla që duhet të bëjë dhe do të ishte mirë që ai të vjen në seancë. Për përqindjet e shpenzimeve dhe për ato qysh po e shohim nuk po duket se është realizue plani qysh është dashtë të realizohet, por sido që të jetë të gjitha do ti bosedojmë në seancë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal Raportin e shpenzimeve për periudhën Janar-Qershor 2022.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti Raportin e Auditimit nga ZKA-ja, për vitin 2021.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që Raporti i Auditimit të shkoj për Kuvend.

Sami Ahmeti – Edhe ne jemi dakord që Raporti i Auditimit të shkoj në Kuvend, por gjithsesi prapë edhe te ky raport është shumë me rëndësi me qenë edhe Kryetari në seancë. Shumë gjëra, ka që konsiderohen lavde dhe është mirë ne me lavdue atë përballë, por gjithashtu edhe dyshimet do ti merrë përsipër sepse është personi i vetëm që është me votë qytetare, ndërsa të tjerët janë të emëruar, kështu që është mirë Kryetari me qenë në seancë.

Kryesuesja – Patjetër, z.Ahmeti nëse Kryetari është i lirë ai do të vijë në mbledhjen e radhës të Kuvendit komunal.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim Raportin e Auditimit, nga ZKA-ja, për vitin 2021.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Ju e keni pranuar edhe Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga ZKA-ja dhe lidhur me këtë plan nëse keni diçka për të thënë mund ta thoni.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që ky plan të shkoj në Kuvend dhe aty do ta japim kontributin.

Sami Ahmeti – Një plan që na është ofrue prej 12 rekomandimeve dhe planit të veprimit të tij, unë do të dëshiroja të quhet plan, por ky po duket njëfarë lloj zotimi se ne nuk kemi me bë më kështu dhe nuk ka ndonjë plan se si dhe në cilat procedura do të realizohet. Do të thotë se në të ardhmen, mos të ketë shkelje të tilla që janë renditë 12. Te rekomandimi shkruan se rekomandimi është shqyrtuar dhe nuk do të përsëritet më, që do të thotë se nuk është plan, por është vetëm zotim. Është mirë që kush e ka bërë këtë plan, ta bëjë pak më të specifikuar për seancë dhe kur shqyrtohet raporti i auditorit gjithsesi ka me u shqyrtue edhe një plan i veprimit se si do të bëhet, prandaj jemi dakord që të bisedojmë në seancë.

Kryesuesja – Gjithsesi, në mbledhjen e radhës të Kuvendit komunal, do të jenë edhe ata që e kanë bërë planin e veprimit dhe mund të diskutohet më gjerësisht lidhur me raportin dhe planin.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga ZKA-ja.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesja – Për një sqarim detal rreth raportit mbi pronat komunale, fjalën ia jepë drejtorit të DPUKP-së.

Arben Berisha – Komisioni i emëruar nga Kryetari, i ka vizituar të gjitha pronat, e ka përgatitë raportin dhe raportin në bazë të të gjeturave në terren.

Enver Gashi – Ne jemi për këtë raport, që të raportohet dhe debatohet në Kuvend.

Sami Ahmeti – Unë e kam lexue këtë raport, i kam lexue edhe raportet e viteve të kaluara dhe e kam bërë një krahasim, ashtu që shumica e të gjeturave janë copy paste, por mbi të gjitha raporti i fundit ka përfshirë edhe luftën në Ukrainë dhe shumë probleme tjera. Mua, më është dukë shumë qesharak në shumë pika, por gjithsesi do të qeshim së bashku në seancën e ardhshme.

Arben Berisha – Kjo, që e thotë parafolësi nuk është në rregullë, megjithatë le të mbetet në ndërgjegjen e tij sepse nuk është copy paste, por janë të gjeturat në terren që Komisioni me përgjegjësi të plotë ka punue në terren dhe mosinvestimi i tyre, arsyeshmëria e tyre ata i kanë citue fjalët e tyre për arsye pse nuk ka mund me investue deri tash. Ata e kanë bërë raportin në mënyrë profesionale dhe nuk është çështje që e kanë përshkrue luftën në Ukrainë dhe nuk është e vërtetë që kanë bërë copy paste në raportet e tyre, për të gjeturat në terren.

Kryesuesja – Unë nuk kisha dashtë me potencue të paktën luftën në Ukrainë, kur jemi vetë dëshmitarë të një lufte, e dijmë shumë mirë çka kemi vuajtë dhe nuk është mirë me përmendë, nëse nuk mundemi me i ndihmue, të paktën mos me u mundue me i njollosë.

Labinot Mirena – E pyes drejtorin se a janë të gjitha tokat e dhëna në shfrytëzim të përfshira në raport, a ka ndonjë tokë psh që nuk ka fillue me u punue hiç dhe nuk ka kurrfarë arsyetimi.

Arben Berisha – Përgjegjet se raporti është për të gjitha pronat, si për ato që është investue, si për ato që nuk janë investue. Po ashtu, janë edhe arsyeshmëritë e kompanive pse nuk kanë investue, janë edhe afatet që iu kanë dhënë nga Kuvendi.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal, shqyrtimin e Raportit mbi pronat komunale.

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën nga drejtori i DPUKP-së, për plotësim ndryshimin e vendimit nr.-I-69, të dt.30.04.2021.

Arben Berisha – Në bazë të ligjit kjo duhet të jetë pikë e rendit të ditës.

Kryesuesja – Për mbledhjen e KPF-së, shkon si kërkesë, ndërsa për mbledhjen e Kuvendit, e kemi përfshirë si pikë e rendit të ditës.

Arben Berisha – Ne e kemi një sugjerim nga Ministria e financave, që kjo pronë të tërhiqet dhe pala ka nënshkruar me deklaratë se pajtohet të tërhiqet për arsye se prekë edhe në pronën e RTK-së, që tash sa e di unë e menaxhon AKP-ja. Krejtë bëhet fjalë për 130 metra, nëse nuk gaboje dhe nuk prish ndonjë çështje te prona e pronarit të mëhershëm.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që kjo kërkesë të shkojë në Kuvend dhe aty të debatohet.

Sami Ahmeti – Në rregullë, le të shqyrtohet edhe kjo pikë e rendit të ditës në Kuvend, ndryshimi i kësaj Rregulloreje, por si është e mundur një Kuvend, një Ekzekutiv me ose pa zyrë ligjore që ka në posedim të gjitha dokumentet e nevojshme dhe të ia jepë në shfrytëzim, ose ta këmbëjë një pronë të huaj me një person privat siç ka ndodhë kjo. Sipas kësaj e shohim se parcela prej, 1,507 m², nuk ka qenë e Komunës, por e Radio Prishtinës. Unë nuk kam koment, por gjithsesi le ta bisedojmë në seancë.

Arben Berisha - Kërkoj falje, që po ndërhyj por devijimin nuk e pranojmë për arsye se nuk është pronë e huaj, por është pronë e Kuvendit komunal. Mirëpo, prekë edhe në rrethojat e Radio Televizionit që i ka rrethue në vitet e hershme, por prona është e Kuvendit komunal. Pronat në atë kohë kanë hy si total, nuk janë 1,626 m, por kjo është tjetër pronë. Ne kemi të bëjmë me këmbim të pronës dhe nuk është Rregullore.

Sami Ahmeti – Neve, si arsyetim na ka ardhë se duhet të ndryshohet vendimi paraprak dhe heqja është ndryshim sepse kur hiqet diçka ndryshohet, kështu kuptohet në gjuhën shqipe. Mirëpo, arsyetimi është se prona me numër kaq është pronë e Radio Kosovës. Sido, që të jetë nuk dua me zvarritë në këtë fazë këtë temë, e bisedojmë në seancë, jam dakord.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim kërkesën e DPUKP-së nr.-V-891, të dt.18.07.2022, për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.-I-69, të dt.30.04.2021.

Kryesuesja – Paraqet kërkesën nga Kryetari i Komunës, për plotësim ndryshimin e vendimit nr.-I-95, të dt.29.06.2022, ashtu që në vend të Naim Miftarit në Komision për zgjedhjen e Këshillave lokale, do të jetë Lendita Bekteshi Memishi dhe në vend të Zelushë Kelmendit, do të jetë Debora Peci nga demokracia plus.

Sami Ahmeti – Në të njëjtën kohë si shef i grupit parlamentar kam marrë një kërkesë nga znj.Albana Shillova Shalaku, e cila tërheqet nga ky Komision për faktin që e shpjeguan edhe në seancën e kaluar se ajo ka një bebe të vogël dhe nuk ka mundësi me marrë pjesë nëpër fshatra. Si rrjedhojë ne si grup parlamentar derisa po bëhen këto ndryshime kërkojmë që nga LVV-ja, të përfshihet z.Valon Svirca, duke pasë parasysh se tani ju si Ekzekutiv, veç keni plotësuar kuotën gjinore sepse kjo ishte edhe arsyeja. Pra, kërkojmë që në këtë ndryshim të hyj edhe z.Valon Svirca.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim kërkesën e Kryetarit të Komunës, nr.-II-982, të dt.21.07.2022, për plotësimin ndryshimin e vendimit nr.-I-95, të dt.29.06.2022.

Kryesuesja – Paraqet kërkesën nga Nderim Kozmaqi, me nënshkrimin e banorëve rezidentë që e shfrytëzojnë aneksin e rrugës "Halil Bici" në fshatin Mazgit, që ai aneks i rrugës në gjatësi prej 120 +80 metra, të fitoj emërtim të ri "Hajriz Kozmaqi".

Sami Ahmeti – Duke dashtë me respektue secilin banorë dhe secilën kërkesë që na drejtohet sepse kanë besim te ne, bëjnë kërkesë dhe ne duhet me trajtue. Më vjen shumë keq që po e them, por është një prej kërkesave më të pandërgjegjshme, që kemi marrë deri tash. Kjo formë, hiqe emrin e atij, se dua të ia vendos të gjyshit tim dhe përveç kësaj kërkesa na ka ardhë pa biografi. Aty, shkruan se është biografia, por ne nuk kemi marrë biografi të personit. Heqja e një emri të martirit të kombit dhe vendosja e një emri të gjyshit, unë besoj se krijon konflikt. Unë e kam një shembull shumë të freskët në një prej fshatrave të Vushtrrisë, që janë përdorë edhe armë për këso rastesh. Mendoj se nuk është mirë ne si Kuvend, por edhe Komisioni me krijue konflikte në mes të familjeve sepse sipas informatave që kam marrë nuk janë 80 % që aty, jetojnë familja Kozmaqi. Aty, ishin edhe 3,4 mbiemra tjerë. Për neve, është krejtë në rregullë kur është me shumicën e qytetarëve, por ne mos të krijojmë konflikte në mes të lagjeve, ose të familjeve. Ndoshta, kurrë nuk e frekuentoj atë rrugë, por do të ishte mirë, që të mos krijojmë konflikte familjare.

Arben Berisha – Unë materialin nuk e kam pranue, por më duket se kjo ka të bëjë me riemërtim të rrugëve. Nëse, është fjala për aneks të rrugës është më ndryshe, por nëse është fjala për riemërtim ligji e trajton, atëherë si aneks të rrugës e trajtojmë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 5 vota për kërkesën e Nderim Kozmaqi nr.- I-18907, të dt.12.07.2022.ia rekomanduan për shqyrtim Komisionit për emërtimin e rrugëve.

Kryesuesja – Ju njoftoj se nga Ministria e ekonomisë kemi marrë konfirmimin ligjor për shfuqizim të vendimit nr.-I-64, të dt.28.04.2022, për aprovimin e Rregullores për subvencionimin e energjisë elektrike dhe caktimin e kuotës më të ulët për çmimin e energjisë elektrike në zonën e rrezikuar mjedisore në Komunën e Obiliqit.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal shfuqizimin e vendimit nr.-I-64, të dt.28.04.2022 të Rregullores për subvencionimin e energjisë elektrike dhe caktimin e kuotës më të ulët për çmimin e energjisë elektrike në zonën e rrezikuar mjedisore në Komunsën e Obiliqit.

Pika 9 e rendit të ditës

Sami Ahmeti – Para disa dite isha te këto lokalet e hekurudhës, te këto lokalet që janë dhënë në shfrytëzim, disa prej personave që kanë dashtë me i marrë dhe te ato lokale asnjëra prej tyre nuk kishte

rrymë. Prej Kuvendit janë të lëshuara, do të thotë prej Komunës së Obiliqit, që janë dislokue ato objektet që kanë qenë te parkingu dhe prej atyre lokaleve, që janë dhënë disa që i rregullojnë lavatriqet çka ishin duke punue aty teneqe punues, po punojshin aty ishin pa rrymë, po punojshin me gjeneratorë. Mendoj se kjo infrastrukturë është dashtë të jetë në rregullë para se përfaqësuesve ekonomik të ju jepen, kështu që është mirë me pasë parasysh dikush kush merret me këtë çështje. Ndoshta, nuk është për pikë të rendit të ditës, por është një problem që ata e cekën që kishin, edhe në këtë vapë nuk kishin me lëshue asnjë lloj klime dhe në të njejtën kohë punët e tyre po i kryejshin me gjeneratorë.

Arben Berisha – Ne e kemi takuar KEDS-in dhe pritet shumë shpejtë që KEDS-i, ka gjetë një kablo furnizuese dhe nuk e ka pranue atë kabllon që ka qenë e paraparë. Tash, jemi ra në ujdi me KEDS-in dhe kjo besoj se lidhet shumë shpejtë.

Labinot Mirena – Mendoj se është gabimi më i madh i yni që e kemi votue për me shkue tregu aty, ka parking të pamjaftueshëm, janë 2 komplekse banesore, aty që janë banesat e Hades, një kompleks i ri që tash lëshohet. Aty e kanë zënë njëfarë pamje që as nuk kanë parking të mjaftueshëm banorët në banesat që vijnë aty. Pra, e kemi heqë një treg te banesat këtu, që është bërë parkingu tash shumë mirë dhe e kemi vendosë një treg atje poshtë, që për momentin dhe mendimin tim është jofunksional dhe do të jetë jofunksional gjithmonë.

Arben Berisha – Sa i përket funksionalizimit të tregut, ai është funksional dhe të gjitha lokalet i kemi dhënë në shfrytëzim, të cilat janë duke punuar me përjashtim që tash kemi telashe me rrymën, por edhe rryma shumë shpejtë do të rregullohet. Sa i përket parkingjeve, ajo është diçka tjetër që Kryetari ka mendue me i organizue parkingjet përballë Hade dhe Hade 1, ndërsa objekti i ri e ka me plan rregullativ, me leje ndërtimore ku i ka parkingjet, nuk ka ndonjë telashe.

Mbledhja përfundoi në ora 10:39'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli

